



## KOMUNA E RAHOVECIT

OPSTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY OF RAHOVEC

### KONTRATË

Numri i kontratës:<sup>1</sup> 623-24-10125-2-3-6/C628

Emri i Autoritetit Kontraktues: **KUVENDI KOMUNAL - RAHOVECË**, në njërën anë; dhe

Emri i Kontraktuesit: **Radio Kosova e Lirë, Thimi Mitko, PRISHTINË, 600420111**, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për shërbimet e shënuara me poshtë:

Titulli i Kontratës: **PUBLIKIMI I KOMUNIKATAVE, I NJOFTIMEVE DHE I PUBLIKIMEVE TË TJERA NË MEDIE ELEKTRONIKE, NË RADIO DHE NË FAQE UEB**

Me numër identifikues: 623-24-10125-2-3-6

#### Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës do të jetë: **Publikimi i komunikatave, i njoftimeve dhe i publikimeve të tjera në medie elektronike, në radio dhe në faqe ueb**, sipas specifikimeve teknike të detyrueshme dhe pjesës së ofertës financiare që janë pjesë e kësaj kontrate.

1.2 Kontrata hynë në fuqi me: **datën e nënshkrimit** dhe përfundon për një periudhë **prej 24 Muaj**

1.3 Afati kohor i performances nuk mund të jetë më shumë se [...] nga data e marrjes së urdhërës.

1.4 Vendi për kryerjen e shërbimeve do të jetë: **NË KOMUNËN E RAHOVECIT**

1.5 Incotermi i aplikueshëm do të jetë DDP<sup>2</sup> (Detyra e Dërguar e Paguar).

#### Neni 2 Ligji i aplikueshëm

2.1 Ligji i zbatueshëm do të jetë sipas Nenit 40 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 Për çështjet që nuk mbulohen me dispozita të kontratës, zbatohen ligjet në fuqi në Kosovë. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.

<sup>1</sup> Ju lutemi referojuni këtij numri të kontratës në dokumentet e faturimit dhe pagesës, procedurat dhe transaksionet që lidhen me thesarin.

<sup>2</sup> DDP – Detyra e Dërguar e Paguar- Incoterms 2010 Oda Ekonomike Ndërkombëtare

### **Neni 3 Çmimi**

3.1 Çmimi total i shërbimeve duhet të jetë: **9,240.00 Euro;**

**[Nëntë mijë e dyqind e katërdhjetë Euro]**

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Operatorit Ekonomik sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve gjatë ekzekutimit të kontratës (në përjashtim të çmimeve të atyre artikujve që i nënshtrohen ndryshimit të çmimit sipas berzës përkatëse, nëse aplikohet).

### **Neni 4 Pagesat**

4.1 Pagesa do të bëhet në Euro.

[Autoriteti Kontraktues do të paguaj secilën shumë të detyrimeve pas pranimit të secilës dërgesë]

4.2 Pagesat e detyrimeve sipas një fature të lëshuar nga Operatori Ekonomik duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

### **Neni 5 Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën**

5.1 Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës.

### **Neni 6 Kualiteti**

6.1 Kualiteti i shërbimeve duhet në të gjitha aspektet të plotësojë specifikimet teknike të parashtruara në Dosjen e Tenderit.

### **Neni 7 Garancioni**

7.1 Garancioni do të mbetet valid për... muaj, pas pranimit të shërbimeve.

Shume e sigurisë së ekzekutimit është: **10 % e vlerës së kontratës**, për kohëzgjatjen e periudhës prej: **25 Muaj** nga data e nënshkrimit të kontratës.

### **Neni 8 Vonesat në ekzekutim**

8.1 Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij nuk arrin të realizojë ndonjë ose të gjitha shërbimet brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së shërbimeve të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.

### **Neni 9 Inspektimi dhe testimi**

9.1 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshtërinë, dhe të kontrollojë përparimin e përgatitjes, fabrikimit apo prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për t'u dorëzuar sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshtëria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar.

### **Neni 10 Nën-kontraktimi**

10.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është një marrëveshje me shkrim me të cilin Operatori Ekonomik i beson kryerjen e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë. Operatori Ekonomik nuk duhet të nënkontrakttojë pa autorizim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Autoriteti Kontraktues do të njoftojë Operatorin Ekonomik për vendimin e tij brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

#### Neni 11 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

11.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Operatorit Ekonomik shtatë ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet në vijim: a) Kur operatori ekonomik nuk arrin t'i realizoj obligimet e veta sipas kontratës; b) Dështon në ekzekutimin e kontratës në afatin e caktuar; c). Refuzon urdhrat administrativ të autoritetit kontraktues; d) Ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga autoriteti kontraktues; e). Falimenton; f). Është dënuar nga një gjykatë për një shkelje që ka të bëjë me sjellje profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res-judicata*; g) Operatori ekonomik i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat e përgjithshme financiare; h) shfaqet ndonjë paafësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës.

#### Neni 12 Ndërprerja e Kontratës nga Operatori Ekonomik

12.1 Operatori Ekonomik, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Operatorin Ekonomik shumën që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë; b) vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë; c) si rezultat i forcës madhore, Operatori Ekonomik nuk është në gjendje për të kryer një pjesë materiale të kontratës për më shumë se 180 ditë, për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Operatorit Ekonomik.

#### Neni 13 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore


13.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi, ose vendim arbitrimi.

13.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në **[Gjykata Themelore Prishtinë]** në pajtim me ligjin e Kosovës.

#### Neni 14 Komunikimi

14.1 Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik duhet jap Titullin e kontratës dhe numrin ei identifikimit, dhe duhet të dërgohet me postë, faks, e-mail ose me dorë.

E hartuar në gjuhen [Shqip]<sup>3</sup> në tri origjinale, dy origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një original për Operatorin Ekonomik.

| Për Autoritetin Kontraktues: |                                                                                     | Për Ofruesin e Shërbimeve: |                                                                                       |
|------------------------------|-------------------------------------------------------------------------------------|----------------------------|---------------------------------------------------------------------------------------|
| Emri:                        | Astrit Mullabazi                                                                    | Emri:                      | Ahmet Qeriqi                                                                          |
| Pozita:                      | Zyrtar përgjegjës i prokurimit                                                      | Pozita:                    | Drejtor                                                                               |
| Nënshkrimi:                  |  | Nënshkrimi:                |  |
| Data:                        | 04.11.2024                                                                          | Data:                      | 04.11.2024                                                                            |
| Vula:                        |  | Vula:                      |  |

<sup>3</sup> Gjuha do të jetë gjuha e përdorur nga tenderuesi në tenderin e tij.

## **Aneksi 1. SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME**

1. Operatori Ekonomik duhet të sigurojë emetimin e të gjitha lajmeve, kumtesave dhe pasqyrimin e aktiviteteve ditore të Kryetarit, Nënkryetarit, Drejtorëve të Drejtorive Komunale në emisionet kryesore të informative dhe të njëjtat të botojë për çdo ditë, atëherë kur ka lajme të tilla në ueb faqen e vet, në ballin dhe me shkronja të cilat do të bien në sy;
2. Nëse paku në dy emisione kryesore informative operatori ekonomik do të lexon në tërësi kumtesat dhe lajmet të cilat i dërgohen nga zyra e Informimit të Komunës së Rahovecit;
3. Do të afishohet logoja e Komunës së Rahovecit me dimensionet 300x250 px dhe ajo në rast nevojë do të rifreskohet;
4. Në ballin të ueb faqes do të jetë linku i cili drejtpërdrejtë lidhet me ueb faqen e Komunës së Rahovecit;
5. Publikimi i Konkurseve si dhe urimi i festive shtetërore dhe fetare sipas nevojave të Komunës;
6. Publikimi i Komunikatave, artikujve dhe intervistave sipas kërkesës së Komunës së Rahovecit;
7. Për prezantimin e aktiviteteve publike të Kryetarit, afishimin e logos së Komunës së Rahovecit publikimin e njoftimeve, konkurseve, urimeve, sporteve të ndryshme reklamuese në ueb faqe;
8. Publikimi i komunikatave, njoftimeve dhe publikimeve tjera në media elektronike Radio dhe ueb faqe

## Deklaratë

Mbi specifikimet teknike të detyrueshme

**Operatori Ekonomik Radio Kosova e Lirë** përmes kësaj deklarate konfirmon se ka lexuar të gjitha specifikimet teknike të detyrueshme në ANEKS 1 të dosjes së tenderit numri i prokurimit 623-24-10125-2-3-6 numri i brendshëm 623-24-058-2-3-6 **Titulli: PUBLIKIMI I KOMUNIKATAVE, I NJOFTIMEVE DHE I PUBLIKIMEVE TË TJERA NË MEDIE ELEKTRONIKE, NË RADIO DHE NË FAQE UEB** dhe pajtohem që me rastin e kontraktimit të kësaj kontrate do të zbatohen me përpikëri përfshijë të gjitha ligjet relevante për shërbime të tilla.

Radio Kosova e Lirë

Përgjegjësi i Marketingut

Jeton SYLA



**PËRSHKRIMIT TË ÇMIMIT: PUBLIKIMI I KOMUNIKATAVE, I NJOFTIMEVE DHE I PUBLIKIMEVE TË TJERA NË MEDIE ELEKTRONIKE, NË RADIO DHE NË FAQE UEB**

| Nr.    | Emri i projektit                                                                                                                                                                               | Njësia | Sasia | Çmimi  | Shuma    |
|--------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--------|-------|--------|----------|
| 1.     | Publikimi i komunikatave, i njoftimeve dhe i publikimeve të tjera në medie elektronike, në radio dhe në faqe ueb – Sipas kërkesave të dhëna në Aneksin 1 – Specifikimet teknike të detyrueshme | Muaj   | 24    | 385.00 | 9.240.00 |
| TOTALI |                                                                                                                                                                                                |        |       |        | 9.240.00 |

*Çmimi duhet të jetë konform të gjitha tatimeve dhe detyrimeve në Republikën e Kosovës*

